



Npi – 01/77 datë: 15.03.2023

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, pas procesit të diskutimit Publik, në mbledhjen e mbajtur më 15.03.2023, Miratoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2023

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 15.03.2023, me shumicën e votave, miratoi Rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoja për vitin 2023.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi